

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT  
SEKSIONI I TRETË

**ÇËSHTJA ILIRIA SHPK KUNDËR SHQIPËRISË**  
(Kërkesa nr. 31011/09)

VENDIM  
STRASBURG  
5 mars 2024

*Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial*

**Në çështjen Iliria sh.p.k. kundër Shqipërisë,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:  
Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 31011/09) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") më 6 prill 2009 nga shoqëria italiane, Iliria sh.p.k. (në likuidim) ("shoqëria kërkuese") e regjistruar në Napoli dhe e përfaqësuar fillimisht nga z. A. Hakani dhe më pas nga z. A. Saccussi, avokat i licencuar në Romë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën sipas nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga Agjencia në atë kohe znj. A.Hicka dhe më pas nga z. O.Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

faktin që qeveria italiane nuk ka kërkuar të ushtrojë të drejtën e saj për të ndërhyrë (neni 36 § 1 i Konventës dhe rregulli 44 § 1 i Rregullores së Gjykatës);

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 6 shkurt 2024,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në atë datë:

**OBJEKTI I ÇËSHTJES**

1. Çështja ka të bëjë me një ankesë sipas nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, që kohëzgjatja e procesit gjyqësor në lidhje me njohjen (*exequatur*) e një vendimi të arbitrazhit ndërkombëtar ka qenë e paarsyeshme.

**I. PROCESET E NJOHJES FILLESTARE**

2. Më 3 shtator 1993, pas fillimit të procesit në arbitrazh nga shoqëria kërkuese, një tribunal ndërkombëtar arbitrazhi i krijuar bazuar në një marrëveshje arbitrazhi urdhëroi qeverinë shqiptare që t'i paguajë shoqërisë kërkuese 48,239,000,000 lira italiane ("ITL") dhe një interes vjetor me normë 13% ("vendimi i arbitrazhit").

3. Më 25 maj 1995, Ministria e Financave informoi shoqërinë kërkuese se ajo do të paguante borxhin e saj pasi të merrte kredi nga bankat e huaja.

4. Më 11 mars 1998, shoqëria kërkuese paraqiti një kërkesë (d.m.th., pa përmendur një palë kundërshtare) që Gjykata e Apelit Tiranë të njohë (*exequatur*) vendimin e arbitrazhit në rendin juridik shqiptar.

5. Më 2 prill 1998, Gjykata e Apelit Tiranë miratoi kërkesën dhe njohu vendimin e arbitrazhit duke e bërë atë të ekzekutueshëm. Meqë ky vendim i referohej vetëm shumës së principalit, më 5 maj 2000

po kjo gjykatë e plotësoi vendimin e saj të parë duke njohur detyrimin e debitorit për të paguar edhe interesat (“Vendimet e njohjes fillestare”).

6. Më 3 gusht 1998, Këshilli i Ministrave udhëzoi Ministrinë e Financave të vepronte në përputhje me ligjet në fuqi për borxhin ndaj shoqërisë kërkuese.

7. Më 11 nëntor 1998 dhe 20 maj 2002, një përmbarues i dërgoi Këshillit të Ministrave informacionin për borxhin ndaj shoqërisë kërkuese dhe rekomandoi që palët të hynin në negociata për kushtet e pagesës.

## II. KËRKESË PËR RIVENDOSJE NË AFAT

8. Në një datë të pa specifikuar, Këshilli i Ministrave depozitoi në Gjykatën e Apelit Tiranë një kërkesë për ankim jashtë afatit (*rivendosje në afat*) kundër vendimeve të njohjes fillestare. Më 26 dhjetor 2003, Gjykata e Apelit Tiranë pranoi kërkesën me arsyetimin se vendimet e kundërshtuara nuk i ishin njoftuar Këshillit të Ministrave.

## III. PROCESET VIJUESE

9. Më 5 janar 2004, Këshilli i Ministrave bëri ankim për çështje të ligjit kundër vendimeve të njohjes fillestare.

10. Më 10 shkurt 2005, Gjykata e Lartë i prishi ato vendime dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim. Ajo gjeti se Këshillit të Ministrave duhej t’i jepej mundësia për të kundërshtuar njohjen e vendimit të arbitrazhit.

11. Më 14 shkurt 2006, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes. Ajo gjeti se përfaqësuesi i shoqërisë kërkuese nuk kishte marrë një autorizim të vlefshëm nga drejtuesi i saj për të filluar proceset e njohjes në Shqipëri. Shoqëria kërkuese bëri ankim për çështjet e ligjit.

12. Më 9 maj 2007, Gjykata e Lartë mbajti një seancë për çështjen dhe më 26 shtator 2007 e prishi vendimin e gjykatës më të ulët duke e kthyer çështjen për rishqyrtim. Ajo gjeti se gjykata e apelit nuk e kishte dëgjuar shoqërinë kërkuese për çështjen e autorizimit dhe nuk i kishte dhënë asaj mundësinë për të korrigjuar gabimet e pretenduara në këtë drejtim.

13. Më 31 mars 2009, Gjykata e Apelit rrëzoi kërkesën e shoqërisë kërkuese për njohjen dhe zbatimin e vendimit të arbitrazhit. Ajo u shpreh se vendimi ishte në kundërshtim me parimet bazë të ligjit shqiptar.

14. Më 12 prill 2012, Gjykata e Lartë hodhi poshtë ankimin e shoqërisë kërkuese për çështjet e ligjit me anë të një vendimi *de plano*, duke vënë në dukje se ai nuk përfshinte asnjë argument të pranueshëm në shkallë të lartë.

15. Shoqëria kërkuese depozitoi një ankim kushtetues në një datë të pa specifikuar (“ankimi i parë kushtetues”).

16. Më 2 maj 2013, Gjykata Kushtetuese mbajti një seancë për çështjen dhe më 10 korrik 2013 shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Lartë. Ajo vëren se Gjykata e Lartë duhet të kishte dhënë më shumë arsye në përgjigje të argumenteve të shoqërisë kërkuese.

17. Më 4 tetor 2013, Gjykata e Lartë vendosi edhe një herë kundër shoqërisë kërkuese.

18. Më 2 dhjetor 2014, shoqëria kërkuese paraqiti një tjetër ankim kushtetues, ndër të tjera, për kohëzgjatjen e procesit.

19. Më 14 prill 2015, Gjykata Kushtetuese mbajti një seancë për çështjen dhe më 22 dhjetor 2015 rrëzoi ankimin. Për sa i përket kohëzgjatjes së procesit, gjykata bëri dallimin midis dy periudhave të ndryshme.

20. Sipas Gjykatës Kushtetuese, periudha e parë përkatëse fillonte më 31 mars 2009 kur Gjykata e Apelit Tiranë kishte dhënë vendimin e saj mbi themelin e çështjes dhe përfundonte kur Gjykata e Lartë kishte dhënë vendimin e saj të datës 12 prill 2012 (shih paragrafët 13 dhe 14 më lart). Në lidhje me këtë periudhë, gjykata u shpreh se kërkuesi nuk kishte paraqitur asnjë ankim për kohëzgjatjen e

proceseve në ankimin e tij të parë kushtetues, ndaj nuk ishte ankuar brenda afatit kohor ligjor prej 2 vitesh.

21. Periudha e dytë fillonte më 10 korrik 2013 kur Gjykata Kushtetuese kishte dhënë vendimin e saj të parë (shih paragrafin 16 më lart) dhe përfundonte më 4 tetor 2013 kur Gjykata e Lartë kishte dhënë vendimin e saj të dytë (shih paragrafin 17 më lart). Kjo periudhë sipas gjykatës nuk shfaqti ndonjë vonesë.

#### VLERËSIMI I GJYKATËS

#### SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6, PARAGRAFI 1, TË KONVENTËS PËR SHKAK TË KOHËZGJATJES SË PROCESIT GJYQËSOR

22. Kërkuesi u ankuar në bazë të nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në lidhje me njohjen e vendimit të arbitrazhit ishte e paarsyeshme.

#### A. Çështje paraprake

23. Qeveria pretendoi se meqenëse shoqëria kërkuese ishte nën likuidim, është e paqartë se kush e kishte fuqinë e përfaqësimit të saj para Gjykatës.

24. Megjithatë, kërkesa fillestare u depozitua në bazë të një prokure të noterizuar nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve të shoqërisë kërkuese (*Presidente del consiglio d'amministrazione*). Pas shpalljes së shoqërisë kërkuese në likuidim, më 22 dhjetor 2015, likuiduesi autorizoi z. A. Saccucci. Gjykata konsideron se nuk lind asnjë problem në këtë aspekt.

#### B. Pranueshmëria

25. Qeveria parashtroi se kërkesa e brendshme e shoqërisë kërkuese u refuzua përfundimisht për themelin, prandaj ajo nuk pësoi asnjë dëm nga vonesat e pretenduara dhe rrjedhimisht nuk kishte status viktime para Gjykatës. Megjithatë, Gjykata vëren se shoqëria kërkuese kishte të drejtën sipas ligjit të brendshëm për një vendim nëse vendimi i arbitrazhit ishte i ekzekutueshëm në Shqipëri apo jo. Prandaj, pavarësisht nga rezultati i proceseve të brendshme, shoqëria kërkuese mund të pretendojë se është viktimë e zgjatjes së paarsyeshme të proceseve në fjalë.

26. Pretendimi i qeverisë se kërkesa është abuzive, pa ndonjë shpjegim të mëtjeshëm të arsyeve që mbështesin këtë argument, hidhet poshtë.

27. Qeveria argumentoi më tej se shoqëria kërkuese kishte filluar proceset e *exequatur* në Itali, prandaj ankimi para Gjykatës është i parakohshëm. Megjithatë, Gjykata vëren se proceset në Shqipëri kanë përfunduar më 22 dhjetor 2015, kur Gjykata Kushtetuese ka dhënë vendimin e saj përfundimtar për këtë çështje (shih paragrafin 19 më lart), prandaj kundërshtimi i qeverisë hidhet poshtë.

28. Gjykata vëren se kjo kërkesë nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës ose e papranueshme bazuar në ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

#### C. Themeli

29. Gjykata rithekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuesve dhe autoriteteve përkatëse dhe atë që ishte në diskutim për kërkuesit në mosmarrëveshje (shih, mes shumë vendimeve të tjera, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës* [DHM], nr. 25444/94, § 67, GJEDNJ 1999-II, dhe *Frydlender kundër Francës* [DHM], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII).

#### 1. Periudha përkatëse

30. Gjykata nuk është në gjendje të ndjekë konstatimin e Gjykatës Kushtetuese se proceset filluan më 31 mars 2009, kur Gjykata e Apelit Tiranë dha vendimin e saj të fundit mbi themelin e çështjes (shih paragrafin 20 më lart). Ajo konstaton, në përputhje me praktikën e konsoliduar gjyqësore se proceset në fjalë filluan më 11 mars 1998 kur shoqëria kërkuese paraqiti kërkesën e saj për njohjen e vendimit të Arbitrazhit në Shqipëri (shih paragrafin 4 më lart).

31. Periudha përkatëse përfundoi më 22 dhjetor 2015, kur Gjykata Kushtetuese dha vendimin përfundimtar për këtë çështje, duke shënuar kështu përfundimin e procesit (shih paragrafin 19 më lart). Prandaj, procesi zgjati 17 vjet e 9 muaj përpara nëntë shkallëve të juridiksionit.

2. *Sjellja e kërkesit dhe kompleksiteti i çështjes*

32. Gjykata vëren se një vonesë fillestare prej 5 vitesh e 8 muajsh ndodhi ndërmjet vendimit të parë të vitit 1998 që njihete zbatueshmërinë e vendimit të arbitrazhit dhe deri në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të vitit 2003, që pranoi kërkesën e Këshillit të Ministrave për rivendosje në afat (shih paragrafët 5 dhe 8 më lart). Nuk ka asnjë të dhënë që mosnjoftimi i Këshillit të Ministrave për vendimet fillestare i atribuohet shoqërisë kërkuese.

33. Vonesat e mëvonshme ndodhën si rezultat i faktit se vendimet e njohjes fillestare nuk u ankimuan në Gjykatën e Lartë (shih paragrafin 10 më lart) dhe as vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë i datës 14 shkurt 2006 (shih paragrafin 11 më lart). Edhe pse nuk i takon Gjykatës në këtë kontekst që të analizojë cilësinë e vendimmarrjes së gjykatave të brendshme, kthimi i çështjes për shqyrtim zakonisht urdhërohet si rezultat i gabimeve të kryera nga gjykatat më të ulëta, dhe disa kthime brenda të njëjtave procese gjyqësore mund të zbulojnë një mangësi të rëndë në sistemin gjyqësor, duke zgjatur në mënyrë të konsiderueshme kohëzgjatjen e përgjithshme të proceseve gjyqësore. Gjithashtu, kjo situatë i ngarkohet autoriteteve dhe jo kërkuësve (shih *Vlad dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 40756/06 dhe 2 të tjerë, § 133, 26 nëntor 2013, me referenca të mëtejshme).

34. Kjo vonesë prej një viti e gjashtë muaj ka ndodhur ndërmjet 26 shtatorit 2007, kur Gjykata e Lartë shfuqizoi vendimin më të ulët, dhe 31 marsit 2009, kur Gjykata e Apelit Tiranë vendosi sërish për këtë çështje (shih paragrafët 12 dhe 13 më lart). Një vonesë e mëtejshme prej gati tre vitesh ndodhi ndërmjet vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 31 mars 2009 dhe vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 12 prill 2012 (shih paragrafët 13–14 më lart dhe *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, § 95, 1 prill 2014). Në veçanti duket se gjatë kësaj periudhe Gjykata e Lartë nuk ka zhvilluar asnjë seancë apo nuk ka ndërmarre ndonjë hap tjetër procedural në shqyrtimin e çështjes.

35. Në fund, një vonesë ndodhi gjithashtu për shkak se vendimi i Gjykatës së Lartë i 12 prillit 2012 u shfuqizua dhe u kthye për rishqyrtim nga Gjykata Kushtetuese (shih paragrafin 16 më lart dhe *Vlad*, cituar më lart, § 133).

36. Këto vonesa nuk mund t'i atribuohen sjelljes së shoqërisë kërkuese. Nëse parashtrimet e kësaj të fundit para gjykatave të brendshme nuk ishin të plota, siç parashtrroi qeveria, gjykatat e brendshme mund të dilnin në këtë përfundim brenda një kohe të arsyeshme.

37. Prandaj, Gjykata vëren se pretendimi i qeverisë që vonesa ishte shkaktuar nga sjellja e vetë shoqërisë kërkuese nuk është i bazuar.

38. Gjykata nuk mund të pranojë as pretendimin e qeverisë se vonesat u shkaktuan nga kompleksiteti i çështjes që përfshinte përcaktimin e çështjes së zbatueshmërisë së vendimit të arbitrazhit në Shqipëri.

Edhe nëse çështja kishte njëfarë kompleksiteti, vetëm kjo nuk mund të justifikonte proceset ligjore që zgjatën 17 vjet e 9 muaj.

39. Në këto rrethana është shkelur neni 6 § 1 i Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor.

#### ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

40. Shoqëria kërkuese nuk paraqiti pretendim për kompensim të drejtë në lidhje me dëmin monetar, prandaj Gjykata nuk vendos për këtë objekt.

41. Shoqëria kërkuese pretendoi 100,000 euro (EUR) për dëmin jopasuror. Qeveria e kundërshtoi pretendimin si të paarsyeshëm. Duke vendosur mbi baza të drejta, Gjykata cakton për shoqërinë kërkuese shumën 4800 EUR për dëmin jopasuror.

42. Shoqëria kërkuese pretendoi 21,000 euro (EUR) për kosto dhe shpenzime të kryera përpara gjykatave të brendshme. Ajo paraqiti faturat përkatëse në mbështetje të pretendimit. Qeveria e kundërshtoi pretendimin si të paarsyeshëm. Gjykata nuk konsideron se të gjitha shpenzimet e bëra nga shoqëria kërkuese përpara gjykatave të brendshme janë të lidhura me zgjatjen e paarsyeshme të procesit gjyqësor. Duke pasur parasysh dokumentet e paraqitura, Gjykata e vlerëson të arsyeshme t'i caktojë shoqërisë kërkuese 6000 euro për këtë objekt.

43. Shoqëria kërkuese nuk paraqiti pretendim për kosto dhe shpenzime të bëra përpara Gjykatës, prandaj Gjykata nuk vendos për këtë objekt.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, ME UNANIMITET,

1. *rrëzohet* kundërshtimet paraprake të qeverisë;
  2. *shpall* kërkesën të pranueshme;
  3. *vendos* që është shkelur neni 6 § 1 i Konventës për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor;
  4. *vendos*:
    - a) që shteti i paditur t'i paguajë shoqërisë kërkuese, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme:
      - i. 4800 (katër mijë e tetë qind euro) EUR për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet;
      - ii. 6000 (gjashtë mijë euro) EUR për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit;
    - b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme, sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;
  5. *rrëzohet* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesit për kompensim të drejtë.
- Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 5 mars 2024, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Olga Chernishova**  
ZËVENDËSKANCELARE

**Georgios A. Serghides**  
PRESIDENT